



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA OF KOSOVA

K. Nr. 4270/2012

**Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj**, me gjyqtarin Gani Veseli dhe procesmbajtset Florie Gueati, duke vendosur në çështjen kundërvajtëse kundër të pandehurit, Skender Beqir Tahiraj, nga fshati Klinë e Epërme, Komuna e Skenderajt, për shkak të kundërvajtjes të shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupsion, Nr. 043/L – 50 të Republikës së Kosovës, lidhur me neni 9 dhe 10 të LMK-ës, si dhe në kuptim të nenëve 30,31,37,74,195, të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.20.12.2013, mori:

## A K T V E N D I M

**I pandehuri** : I. Skender Tahiraj, i lindur më 03.11.1972, në fshatin Klinë e Epërme, me vendbanim në Klinë e Epërme, i punësuar, i martuar, me profesion ; shkollën e lartë ekonomike, kushtet ekonomike të mesme, shqiptar - shtetas Kosovar.

### Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

**Sepse** në muajin Mars të vitit 2012, zyrtari i Lartë Publik, nuk ka përmbydhur obligimin Ligjor që parashihet me Ligjin 04/L-050, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtërve të lartë publik.Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, ku nuk ju kanë papërmbytur nenit 9 të këtij Ligji.

Me këtë i pandehuri ka bërë kundërvajtje nga neni 17.al.1.pika 3, të Ligjit mbi deklarimin e pasurisë..

## D E N O H Ë T

**ME DËNIM Qortimi** për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 1 të Ligjit Antikorrupsion të Republikës së Kosovës.

I pandehuri ngarkohet me paushall gjuqësor në shumë prej 10 Euro, në kuptim të nenit 109.al.1.pika 6 të LMK-ës, pagesa e kësaj shume bëhet në arken e kësaj gjykate në afatin prej 15 ditësh pasi që vendimi të merr formën e prerë.

Nganjë kopje e këtij Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit .

## A r s y e t i m i

Agjensioni Antikorrupsion, ushtroi kërkesën e vet, nr.01-25/2/12 të dt.13.07.2012, me qëllim të hapjes dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të Lartëtheksuar, për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupsion.

Gjykata pas shiqimit të kërkesës të ushtruar nga ana Agjensionit Antikorrupsion, konstatoi se kërkesa I plotëson kushtet për zhvillimin e procedurës.Gjykata mori Konkluzion mbi zhvillimin e procedurës kundërvajtëse me dt. 27.02.2013 dhe caktoi senacën e shqyrtimit për dt. 16.10.2013, ndërsa në pyetje u muar me dt.17.12.2013, dhe në mbrojtjen e tij i pandehuri shtoi:Është e vërtetë se unë nuk e kam deklaruar, gjegjësishtë nuk e kam mbushur formularin me kohë për deklarimin e pasurisë, për shkak se nuk kam ditur, sepse unë jam vendosë në funksion me 06.03.2012 dhe kur më kanë njoftuar se nuk e kam plotësuar këtë aplikacion, atëherë pas vërejtjes unë e kam mbushur këtë aplikacion me dt. 19.04.2012.ku në Gjykatë deponon provën - vërtetimin nr. 03./694/13, të dt. 19.04.2012, i cili mbetet në shkersat e lëndës, të lëshuar nga Agjensioni Antikorrupsion

Gjykata pas shiqimit dhe vlerësimit të provave në shkersat e lëndës si dhe nxjerrjes së provave në procedurë, erdhi në përfundim se i pandehuri Skender nuk kishte përmbydhur obligimin ligjor- deklarimin e pasurisë përmes aplikacionit ta Agjensionit Antikorrupsion për muajin Mars të vitit 2012. Këtë e obligim e ka përmbydhur pas afatit të paraparë me Ligj, me dt. 19.04.2012. Prandaj me këtë i njëjti ka bërë veprë kundërvajtëse – mospërmbyjtje të afatit ligjor për deklarimin e pasurisë . Për kundërvajtjen e shkaktuar i njëjti mbanë përgjegjësi ligjore dhe Gjykata mu për këtë, të njëjtin e shpalli fajtor duke i shqiptuar një dënim qortimi në kuptim të nenëve 17.al.1.pika 3 ,lidhur me nenin 9 dhe 10 të LMK-ës.

Gjykata ndaj të pandehurit aplikoi nenet 9 dhe 10 të LMK-ës për zbutje të jashtëzakonshme dhe dënim Qortimi, për shkak se i pandehuri veprën kundërvajtëse nuk e ka bërë me qëllim, por kjo ka qenë si pasojë që nuk e ka ditur se duhet të bëjë një deklaram të tillë dhe se i njëjti e ka marrë mandatin në muajin kur është dashur të bëhet deklarimi i pasurisë. Gjykata mendon se dënim i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet dhe se është i mjaftueshëm për peshën e përgjegjësisë të të pandehurit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të dënimit mori parasyshë rrethanat lehtsuese dhe rënduese nda, të pandehurit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Gjykata Themelore në Mitrovicë- dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj.**

Skenderaj, më dt.20.12.2013.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës kanë të drejtë ankese, në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit, Departamentit të përgjithshëm – Divizionit të kundërvajtjeve Në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate

